

Faleminderit, zonja Kryetare e Kuvendit!

Në fakt, u bënë disa minuta që po dëgjoj fjalimet e kolegëve të opozitës dhe natyrshëm më lindi një pyetje, për të cilën nuk pres përgjigje nga ju: po ndonjë gjë të mirë a e bënë këta? Vaksinimi anticovid është një proces jetik jo vetëm për vendin tonë, por për të gjithë botën. Natyrshëm apeli i parë që duhet të vijë nga çdokush në këtë sallë duhet të jetë pikërisht thirrja për vaksinim, drejtuar të gjithë atyre që kanë ngelur ende në qerthullin e dyshimeve mbi efektin e vaksinave, dyshime që nuk i mbjellin thjesht injorantët, gjithologët, matrapazët, konspiracionistët, por edhe politikanë të papërgjegjshëm, me qëndrime cinikësh edhe mospërfillësish, që mohojnë çdo përpjekje pozitive në ndihmë të ruajtjes së jetës dhe të shëndetit të qytetarëve tanë.

Kur të bëjmë këtë debat duhet të kthehemi pas në kohë dhe të krahasojmë çfarë bëmë ne që nga fillimi e deri tani dhe çfarë bëtë ju. Ne ishim këtu në Kuvend dhe miratuam e diskutuam për çdo nevojë. U bëmë pjesë e instrumentit COVAX që në fund të vitit që shkoi dhe nuk ndenjëm në pritje, sepse e dinim se si e filloi Bashkimi Europian këtë punë në fillim, por negociuam me çdo faktor shtetëror dhe joshetëror për të sjellë këtu sasinë e parë të vaksinave. Për këdo që e ka harruar, sasia e parë e vaksinave ka ardhur në fund të janarit. Kur u tha një fjalë e mirë? A mos u tha kur ishim ne të parët në rajon që sollëm sasinë e vaksinave në Shqipëri? A mos vallë nuk u komentua dhe nuk u tha çdo gjë kur filluam të bënim vaksinimin me prioritet? Filluam vaksinimin me prioritet të të moshuarve, duke përzgjedhur në radhë të parë personalitete të artit, të shkencës dhe të kulturës. Sa baltë u hodh, a e kujtoni? Po premtimin e Lulit se do të sillte vakcina, duke negociuar me Partitë Popullore Europiane, a e kujtoni? Premtimet i mori era, fjalët e mburravecëve u tretën e humbën si të mos ishin thënë ndonjëherë, ndërkohë që, fatmirësisht, vaksinimi vijoi. Filloi me prioritet dhe tani jemi te vaksinimi i hapur që prej 3 muajsh, vaksinim masiv, falas dhe për të gjithë kategorinë për të cilën Komiteti Teknik ka rënë dakord, nga 18 vjeç e sipër. Është vaksinuar ndërkohë i gjithë personeli mjekësor pa përjashtim, edhe ata që ishin në pension, të moshuarit, mësuesit, pedagogët. Pedagogët tuaj i kam dëgjuar gjatë periudhës para zgjedhjeve që thoshin: patjetër që do ta bëj vaksinën. Mund të thoshin faleminderit dhe shumë mirë që u kujdesët që t'i sillnit këto vakcina policët, punonjësit e medias dhe kushdo që e ka kuptuar dhe e kupton që vakcina është e vetmja zgjidhje që ofron shkenca për t'ia dalë pandemisë. Na matni me gjithkënd, a thua sikur ka një garë kush do të dalë i pari, kush do të dalë i fundit dhe se kush do ta marrë kurorën e dafinës mbi kokë. Po, ka garë, por gara nuk është statistika as e një dite dhe as e një jave, gara është kush mbron jetë, kush përpiqet më shumë dhe bën çdo gjë dhe kush advokon më shumë në mbrojtje të jetës dhe të shëndetit, kjo është gara. Deri më sot në Shqipëri kanë mbërritur mbi 2 milionë vakcina dhe deri në fund të vitit do të jenë 3 milionë vakcina në dispozicion. 36 milionë euro janë dhënë nga buxheti i shtetit për blerjen e sasisë totale të vaksinave, përfshirë edhe këtë për të cilën bën fjalë marrëveshja që jemi duke diskutuar sot. Meqë erdhëm në këtë pikë, dua të tërheq vëmendjen e disa kolegëve, sepse akti normativ nuk ndryshohet, votohet ose jo, këtë thotë Kushtetuta.

Dëgjova disa kolegë të ankoheshin se kishin bërë sugjerime, por nuk i kishte dëgjuar njeri. Ne jemi këtu pikërisht për të ekspozuar këtë punë, çdo përpjekje dhe për t'u shprehur se do të jemi konsistentë. Natyrisht, jemi krenarë, sepse ia kemi dalë që ta bëjmë këtë proces të vaksinimit dhe nuk ka ndodhur që dikush të kthehet mbrapa ngaqë nuk ka vakcina. Ne i kemi dhënë ndihmë edhe Kosovës,

kur Kosova nuk kishte asnjë sasi vaksine në territorin e vet dhe ndihemi po kaq mirë që green pass-i, që sot lëshon autoriteti ynë e-albania, është njësoj i vlefshëm me të njëjtin dokument që lëshohet nga çdo autoritet i ngjashëm i vendeve të Bashkimit Europian. Patjetër ndihemi mirë që qytetarët shqiptarë lëvizin lirshëm si të gjithë qytetarët europianë përkundrejt green pass-it dhe po kështu vijnë studimet, jetën e tyre, pa u penguar nga fakti që në Shqipëri nuk bëhet vaksinimi. Nuk po përmend masat e tjera që ne morëm që nga fillimi i pandemisë për të lehtësuar vështirësitë e diçkaje që ndodhi papritur dhe në njëfarë mënyre kapi gafil të gjithë botën. Jo vetëm se këto u thanë këtu, dihen ndërkohë nga përfituesit dhe për mua kjo është më e rëndësishmja, por edhe për një arsye tjetër shumë të thjeshtë: ne fituam zgjedhjet dhe u besuam për një mandat të tretë. Mos mendoni se u besuam rastësisht, por u besuam pikërisht sepse ditëm të përballonim dy fatkeqësi të mëdha natyrore njëherazi, edhe tërmetin, edhe pandeminë. Na akuzoni se këto i bëmë për fushatë poshtë e përprjetë, po i njëjti muhabet. Demek kur ishim në fushatë, çdo proces jetik edhe frymëmarrja duhet të ishte ndërprerë se po garonit ju për pushtet, ndërkohë, zotërinj, ne po qeverisnim dhe po qeverisim, sipas një mandati 4-vjeçar që na e kanë dhënë qytetarët dhe nuk po bëjmë shtriqje të gjata nga gjumi letargjik këtu, sepse me sa duket kështu paska ardhur terezia për ju. Ju nuk ishit kurrkund dhe nuk jeni kurrkund, në fakt, keni ngelur te recitimi që nuk i sjell dobi askujt. Edhe sjellja prej të fortësh, e cila në mënyrë qesharake u vërejt te disa që i njohim prej kohësh ju bën edhe më të dobët. Që prej fillimit të kësaj legjislature, në mbledhje të ndryshme të parlamentit dhe të komisioneve parlamentare personalisht jam përpjekur të shoh ndryshimin, të dalloj atë ndryshim që duhet të vijë nga dikush, nga ju ose të paktën nga ajo pjesë juaja që edhe publikisht ka pranuar se ishte gabim fatal t'i braktisje zgjedhësit, ata që ju sollën në këtë sallë.

Por fatkeqësisht e njëjta gjuhë e vjetër edhe në fytyrat e reja, e njëjta sjelljeje prej lacash lagjeje nuk funksionon jo me ne, nuk funksionon me qytetarët, të majtë, të djathtë apo pa parti fare. Nuk funksionon, sepse qytetarët presin zgjidhje dhe duan të dëgjojnë argumentin dhe argumenti nuk mund të vijë nga dikush që është ende te rruga dhe nuk e di që këtu është parlamenti. Argumenti nuk mund të vijë as nga sjelljet e atyre që bëjnë showman-in apo showgirl -in këtu, në sallën e parlamentit, por argumenti duhet të vijë nga politikanë të zgjedhur, të përgjegjshëm, që kanë parasysh njerëz, fate dhe mundësi, që ofrojnë rrugëdalje përmes ballafaqimit të asaj çfarë është zgjidhje dhe çfarë shitet si e tillë, çfarë është përfitim konkret për qytetarët dhe çfarë është kosto për qytetarët. Po, ne sot jemi të ekspozuar ndaj një krize të re ekonomike. Nuk jemi në çatinë e botës dhe shpresoj që ju nuk e shihni veten në çatinë e botës. Duhet ta fshehim këtë? Jo, ne të paktën nuk e kemi ndër mend, por ta debatojmë po, duke orientuar se si të përballohet, si dilet nga kjo krizë, si mbrohen të moshuarit, si mbrohen njerëzit që jetojnë me ndihmë ekonomike, si mbrohen ata që janë me aftësi të kufizuara, si mbrohet biznesi, si mbrohen kryefamiljarët e vetëm? A dëgjuam ndonjë këtu nga ju, opozita e vendit, që ta thoshte këtë gjë? Askënd! Të ofroni debat të vërtetë kjo nuk është qokë për Partinë Socialiste, përkundrazi për një forcë politike serioze do të ishte avantazh për ta rritur dhe për ta fituar mbështetjen popullore. Ne e kemi seriozisht, edhe me "toret" që i përmendët me aq krenari edhe me të gjithë llojet e "tireve" dhe të "tirëve", sepse "toret" e dini shumë mirë, i ka pritur burgu, do t'i presë burgu dhe i gjithë ndëshkimi që ato meritojnë, sipas ligjit.

Ndërkohë, dua të sjell sërish në vëmendjen tuaj që ne nuk jemi duke mbrojtur asnjë klient të vjetër apo të ri. Këtë po e bëni ju dhe po e bëni në kohën kur ankoheni gjithë ditën se jeni në merak të madh që shqiptarët i ka pllakosur varfëria, mosvëmendja dhe moskujdesi. Këtu do të jemi dhe do t'ju tregojmë në ditët në vijim se si ju jeni duke mbrojtur klientët të vjetër të ishqeverisë suaj, që i kanë sjell dëm në miliona euro këtij shteti dhe këtij vendi dhe këtë gjë do t'ju tregojmë në sy të qytetarëve, prandaj kini durimin t'i dëgjoni hap pas hapi. Me këtë rast do t'ju tregojmë edhe juve, edhe qytetarëve, se mendjemadhësia nuk është gjë tjetër, por veçse faqja tjetër e medaljes që në njërën anë mban

injurancën. Për të gjitha këto arsye nuk e meritoni vëmendjen e qytetarëve, pasi për 5 vjet nuk arritët të reflektonit ndaj të njëjtit mësim që u dhanë qytetarët dhe kjo është fatkeqësi për ju. Faleminderit!